



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 810/ 7 Prot.,

Datë 10.04.2025

V E N D I M

Nr. 472 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.04.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Shërbime, me Nr. REF-39371-02-26-2025, me objekt: Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale, me fond limit 3.974.917 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “FILARA” ShPK, me Nipt K51611059N, Adresa: Rr. e Kavajës, Ish Kombinati Misto Mame, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Korçë.
Adresa: Bulevardi Shën Gjergji, L .12. Korçë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Shkodra Design” ShPK me Nipt K22113002I, Adresa: Rr. Edith Durham, Z. kadastrale 8594, Shkodër.

Operatori ekonomik “Univers Promotions” ShPK, me Nipt K81324039M, Adresa: Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, Tiranë.

Operatori ekonomik “Inpress” ShPK, me Nipt L52122014L, Adresa: Rr. Siri Kodra , ish Blloku Magazinave, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datë 28.02.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-39371-02-26-2025, me objekt: Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale, me fond limit 3.974.917 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 13.03.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE dhe ka kryer renditjen e rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. Inpress ShPK	me vlerë	2,862,000	L. pa TVSH	Kualifikuar
2. FILARA ShPK	“	2,981,187.75	“	Kualifikuar
3. Shkodra Design ShPK	“	2,988,350	“	Kualifikuar
4. Univers Promotions ShPK	“	3,687,000	“	Kualifikuar

II.3 Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **20.03.2025** ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5187, datë 26.03.2025 dhe me Nr. 810/2025 Prot., datë 26.03.2025, nga operatori ekonomik “FILARA” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*” Shërbime, me Nr. REF-39371-02-26-2025, me objekt: Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale, me fond limit 3.974.917 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ka publikuar formularin e publikimit nr. 810/1 prot., datë 27.03.2025 lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, është depozituar “Formulari i paraqitjes së argumenteve”, protokolluar me tonën me nr. 810/2, datë 28.03.2025, nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK, me anë të cilës kundërshton ankesën e operatorit ekonomik “Filara” ShPK.

II.7. Me shkresën ardhur në sistem me nr. 3062/11 Prot., datë 04.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 810/3, datë 04.04.2025 me objekt “*Informacion*”, autoriteti kontraktor, ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës.

Gjithashtu AK ka përcjellë shkresën me nr.3062/2 prot., datë 04.04.2025, protokolluar me tonën me nr.810/4, datë 07.04.2025, me anë të së cilës informon se ka përcjellë në sistem Vendimin e KSHA-së për ankesën.

Referuar Vendimit të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranim të pretendimeve të ngritura në ankesë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, operatori ekonomik “FILARA” ShPK, kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar, argumentuar si vijon:

[...] Në këtë procedurë shoqëria Filara sh.p.k ka interes të ligjshëm dhe është dëmtuar nga veprimet e autoritetit kontraktor, për shkaqe që po i parashtrojmë më poshtë: shoqëria Filara sh.p.k., është e dëmtuar nga veprimet e KVO-së pasi kualifikimi i padrejtë i ofertave të operatorëve ekonomikë “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK. sjell një vlerësim të ri në të cilën kemi 2 (dy) operatorë ekonomik dhe si e tillë ndryshojnë edhe kushtet për ofertat të cilat mund të jenë në kushtet e ofertës anomalsihte të ulët.

Konkretisht nëse skualifikohen ofertat ekonomike operatorët ekonomikë “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK atëherë do të kemi një vlerësim të ri me 2 (dy) oferta ekonomike të vlefshme dhe rrjedhimisht në këtë rast do të ndiqen dispozitat ligjore për një ose dy oferta ekonomike të vlefshme, e cila shprehimisht shprehet që cdo ofertë me uljen nën 25% të fondit limit do të konsiderohet ofertë në kushtet anomalsihte e ulët dhe automatikisht do të jetë e skualifikuar.

Pra, nëse ofertat e operatorëve OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK do të skualifikohen rrjedhimisht do të sjelli që dhe oferta e OE “Inpress” sh.p.k do të rezultojë anomalsihte e ulët dhe në këto kushte do të shpallet fitues oferta ekonomike e operatorit Filara sh.p.k.

Së dyti, kemi bindjen të plotë se OE Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK nuk plotësojnë kriteret e vecanta për kualifikim konkretisht të pikës 2.2.4, si më poshtë vijon:

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makineri shtypi***
- Printer digjital 3 D***
- Pajisje laminuese***

Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria per plastifikim ose makineria per ngjitje.

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi ,kontratë qeraje,kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Në njohje të mirë të fushën ku OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK operojnë dhe në njohje të mjeteve dhe makinerive që ata disponojnë **kemi bindje** që këta OE nuk disponojnë fizikisht, “makineri shtypi”.

Plotësimi i formularit të vetdeklarimit nuk është i mjaftueshem për të vertetuar se këta OE disponojnë fizikisht në ambjentet e shoqërisë së tyre një makineri shtypi. Ata mund të kenë në dispozicion makineri printimi të formateve të ndryshme, po jo një makineri shtypi funksioni i së cilës është mëse i nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Të gjendur në këto kushte, kërkojmë verifikimin në ambjentet e shoqërive “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK nëse realisht e disponojnë makineri shtypi pasi vetëm në këtë mënyrë mund të vërtetojmë se ata zoterojnë kapacitet e domosdoshme për realizim e procedurës objekt prokurimi dhe mbi të gjitha vetëm në këtë mënyrë mund të vërtetojmë nëse ofertat e tyre ekonomike janë të vlefshme për AK Bashkia Korçë.

III.1.2. Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 3062/1 Prot., datë 04.04.2025 ka argumentuar: [...] Në ankesën e OE Filara ShPK nuk parashtrohen fakte dhe prova por ngrihen pretendime apriori për operatorë të tjerë të kualifikuar.

Në kriterin 2.2.4. mbi disponimin e makinerive OE duhet të plotesojnë vetëm kekesat e vendosura nga AK, ky kriter përmbushet me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Theksojmë se OE nuk kanë detyrrimin që të sjellin dokumente mbështetëse në momentin e vlerësimit të ofertave.

Përsa më sipër pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë. [...]

III.1.3. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcat 8,

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makineri shtypi
- Printer digjital 3 D
- Pajisje laminuese

Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria për plastifikim ose makineria për ngjitje.

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese:foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh.

fatura blerje,deklaratë zhdoganimi ,kontratë qeraje,kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”,të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

III.1.4. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike..”.

Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit. 2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës). 3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime. 4. Sistemi i Ankesave Elektronike në ndërveprim me Sistemin e Prokurimit Elektronik gjeneron një kod autentifikimi unik, që u vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar për t’u njohur me atë pjesë të ankesës, për të cilën

ngrihen pretendime. Në asnjë rast Komisioni nuk jep akses në informacion të klasifikuar si sekret tregtar.

III.1.9. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me Ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.10. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që, *ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor*. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për kualifikimin e ofertës së këtij të fundit.

Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ankimuesi ka parashtruar pretendime mbi kualifikimin e operatorëve të tjerë të kualifikuar me vlera të ofertave më të larta se ankimuesi, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi të renditur pas tij në renditjen përfundimtare.

Referuar ankesës operatori ekonomik ngre pretendime si vijon: “...**Në njohje të mirë të fushës ku OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK operojnë dhe në njohje të mjeteve dhe makinerive që ata disponojnë kemi bindje që këta OE nuk disponojnë fizikisht, “makineri shtypi..**

Nëse ofertat e operatorëve OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK do të skualifikohen rrjedhimisht do të sjelli që dhe oferta e OE “Inpress” sh.p.k do të rezultojë anomalisht e ulët dhe në këto kushte do të shpallet fitues oferta ekonomike e operatorit Filara sh.p.k. ”

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se vendimet e autoritetit kontraktor nuk janë të logjikshme apo të padrejta, ankimuesi duhej të kishte

shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të vlerësojë dokumentet në themel pa pasur argumente dhe fakte konkrete mbi shkeljet e konstatuara. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e konstatuara, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë mbështet pretendimet e tij mbi veprimet e KVO-së.

Konkretisht ankimuesi ngre pretendime hipotetike, pa prova dhe fakte konkrete duke supozuar dhe hamendësuar, si vijon:[...] ***Në njohje të mirë të fushës ku OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK operojnë dhe në njohje të mjeteve dhe makinerive që ata disponojnë kemi bindje që këta OE nuk disponojnë fizikisht, “makineri shtypi.. kërkojmë verifikimin në ambjentet e shoqërive ...Nëse ofertat e operatorëve OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK do të skualifikohen, OE Inpres shpk skualifikohet... dhe OE Filara shpk shpallet fitues...[...]*** duke rezultuar konfuz në argumentet e paraqitura mbi operatorët ekonomikë të renditur pas tij. Komisioni gjykon se në rastin konkret, pesha specifike e barrës së provës, për të provuar shkeljet e konstatuar qëndron mbi pretenduesin.

Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë dhe si i tillë në vendimmarrjen e tij, zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai rrezikon dukshëm të mos arrijë të kualifikohet si pasojë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo rregullohet përmes ankimit në KPP. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik “FILARA” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar vlerësimit të kryer nga autoritetit kontraktor, rezulton se operatori ekonomik ankimues “FILARA” SHPK është i kualifikuar me vlerë oferte më të ulët se OE “Shkodra Design” ShPK dhe “Univers Promotions” ShPK, për të cilin paraqet pretendime për skualifikim, duke mos pasur kështu një interes të ligjshëm të ankohet për operatorë ekonomikë të renditur poshtë tij, referuar vlerave të ofertave ekonomike.

Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar me vlera oferte më të larta se ankimuesi .

Edhe nëse hipotetikisht pretendimet e tij qëndrojnë, interesi i ligjshëm i operatorit ekonomik nuk ka sesi të çenohet nga operatorët e tjerë ekonomikë me oferta me të larta se e tij.

Në përfundim të sa më sipër argumentuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e ankimesit nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “FILARA” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-39371-02-26-2025, me objekt: Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale, me fond limit 3.974.917 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshme procedurën e prokurimit në SPE.
3. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “FILARA” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

